



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.900/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e Bekim Hotit kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Malishevë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Malishevë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si i pa rregullt apeli i Bekim Hotit kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Malishevë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Malishevë, me numër ZL.Anr.900/2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017,

A r s y e t i m

Me datën 10.11.2017, PZAP-i ka pranuar një apel nga Bekim Hotit kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Malishevë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Malishevë, me të cilën thekson se në disa vendvotime i janë manipuluar votat e tij në dobi të dikujt tjetër nga subjekti politik PDK.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullsisë së apelit, gjeti se:

Apeli është i pa rregullt

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apeli i parashtruar nga ana e Bekim Hotit kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Malishevë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Malishevë është i parregullt, sepse nuk është e nënshkruar nga Bekim Hoti dhe si i tillë apeli nuk i plotësonë kriteret e Rregullës Nr.02/2015 të nenit 10.6, ku përcaktohet se: Apelet duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga parashtruesi i apeli apo në emër të tij nga personi i autorizuari.

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e apelit, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozitat e lartë theksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbështetje të nenit 11.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.900/2017 më datën 12.11.2017.

**Kryesuese e Panelit
Zyhdi Haziri**



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*